



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 164, Datë 15.05.2023

MBI

**PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGJINËS TË IMPIANTIT
FOTOVOLTAIK TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË DIGËN E
QYRSAQIT, HEC “VAU I DEJËS”, TË SHOQËRISË “KORPORATA
ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” (KESH) SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 7 dhe 8 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 991/6 prot., datë 11.05.2023, të Drejtorive Teknike të ERE-s “Mbi pajisjen me certifikatë të Garancisë së Origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, të shoqërisë Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a.”

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 75, datë 15.03.2023, vendosi të fillojë procedurën për pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, të shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” (KESH) sh.a., për periudhën 13.05.2022-31.12.2022.
- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e mësipërm me shkresën nr. 991/2 prot., datë 23.03.2023, duke i evidentuar dhe dokumentacionin që mbetej ende për t’u plotësuar.

- Në përgjigje, shoqëria ka përcjellë dokumentacion me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 991/5 prot., datë 05.04.2023.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 21.07.2022, është vendosur kualifikimi i këtij impianti fotovoltaik, ndërkohë që rezulton se ky është aplikimi i parë i shoqërisë KESH sh.a., për pajisje me Certifikatë të Garancisë së Origjinës për këtë impiant, i cili sikurse ka rezultuar dhe nga dokumentacioni i administruar gjatë procedurës së kualifikimit të impiantit, është energjizuar më datë 13.05.2022.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 991/4 prot., datë 30.03.2023, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. ka paraqitur informacion në formë tabelare për sasinë e energjisë elektrike të injektuar në rrjetin e transmetimit, të ndarë sipas muajve dhe totalin për vitin 2022, nga ku rezulton se sasia totale e energjisë elektrike e injektuar në rrjet nga impianti fotovoltaik në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës“, për periudhën 13.05.2022-31.12.2022 është 4,203 MWh.
- Në zbatim të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria KESH sh.a., rezulton i plotësuar si më poshtë:
 - Aneksi 1. *Formati i aplikimit*, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar**
 - Neni 7, pika 7.4, *Kërkesa për lëshimin e garancisë së origjinës*, gërmat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”. **Plotësuar**
 - Neni 7, pika 7.5 *Dokumentacioni teknik*, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar**
- Në zbatim të nenit 14.1 të Rregullores, *Garancia e orgjinës lëshohet për një periudhë 12 mujore dhe shteron fuqinë e saj, me përfundimin e këtij afati, të shprehur edhe në certifikatën e lëshuar nga ERE.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pajisë me Certifikatë të Garancisë së Origjinës impiantin fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, të shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” (KESH) sh.a., për periudhën 13.05.2022 – 31.12.2022, për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 4,203 MWh.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI